

LIGJ
Nr. 111/2021

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 49, pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e inputeve bujqësore, ku përfshihen plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, me përjashtim të hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, është 10 për qind. Lista e kategorive të inputeve bujqësore, sipas këtij neni, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Në nenin 51, shkronja “nj” shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 56, pika 38, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në shkronjën “a”, fjalët “50 milionë lekë,” zëvendësohen me fjalët “500 milionë lekë;”.
2. Shkronja “c” shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 148 fjalët “6 për qind” zëvendësohen me fjalët “0 për qind.”.

Neni 5

¹ Ky ligj është përafëruar pjesërisht me direktivën e Këshillit 2006/112/KE, datë 28 nëntor 2006, “Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, numri CELEX 32006L0112, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 347, datë 11.12.2006, faqe 1–118.

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për autorizimet e përjashtimit nga TVSH-ja, të lëshuara nga administrata doganore, para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe për këtë kategori autorizimesh nuk lejohet shtyrja e afatit të përmbushjes së tyre.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 25.11.2021.